Kronikë

Fushë Arrëz/ U 'ngujuan' në banesë prej mëngjesit, vetëdorëzohen 2 të armatosurit në Orosh! RENEA 'blindoi' fshatin (VIDEO)

Report Tv solli pamje ekskluzive nga operacioni i RENEA-s. Njëri prej personave të armatosur, u dëgjua të thërrasë 'Allahu Ekber'. Në zonë mbërriti gjithashtu dhe një autoambulancë.

■ Fushë Arrëz/ Dy të armatosur të ngujuar, policia shoqëron drejt banesës vëllain e njërit prej tyre për negocimin

■ Fshati Orosh i rrethuar nga policia, Report Tv sjell pamjet ekskluzive të banesës ku fshihen 2 personat e armatosur

Armir Mehaj
24 Nëntor, 14:26 | **Përditesimi: 24 Nëntor, 21:25**

Share

Shkodër- Që prej mëngjesit të ditës së sotme një banesë e pabanuar në fshatin Orosh të Fushë Arrëzit, u rrethua nga policia dhe RENEA, pasi brenda saj fshiheshin dy persona të armatosur, të cilët u dorëzuan pas negociatave me familjarët.

Shtëpia ku "u ngujuan" 2 të armatosurit është në pronësi të Mehill Cumraku (Jaku), gjyshi i Julian Cumrakut, 34- vjeç, njëriprej të armatosurve. Personi tjetër i armatosur dyshohet Hamza Uka, ish- punonjës ushtarak, prej kohësh në vëzhgim nga Antiterrori.

Të dy ata mendohet se qëndrojnë të fshehur në këtë banesë që prej 2 muajsh. Dyshja e armatosur qenë nën vëzhgim të antiterrorit, si radikalë. Ish-ushtaraku, Hamza Uka, dikur komando në Irak raportohet të jetë qitës shumë i mirë.

LEXO EDHE:
Veri-Jug/ 'Mir se t'ka pru zoti n'Fisht', udhëtimi përgjatë 'Shtegut të Poezisë Fishtane' dhe bujtinat e Toskanës shqiptare

Hamza Uka dhe Julian Cumraku janë dorëzuar pasi kanë folur me familjarët. Julian Cumraku ka folur me të vëllanë, të cilin Policia e Shtetit e ka marrë nga Lezha dhe dërguar në vendngjarje, ndërsa tjetri është bindur për t'u dorëzuar nga e motra.

Forcat e policisë përdorën megafon për t'i bërë thirrje që të dorëzohen, ndërsa Julian Çumraku i tha fillimisht policisë se unë nuk dorëzohet pasi duan që ta vrasin. Personi tjetër i armatosur dyshohet Hamza Uka, ish- punonjës ushtarak, prej kohësh në vëzhgim nga Antiterrori.

Report Tv solli pamje ekskluzive nga operacioni i RENEA-s. Njëri prej personave të armatosur, u dëgjua të thërrasë 'Allahu Ekber'. Në zonë mbërriti gjithashtu dhe një autoambulancë.

Lajmi në përditësim...

Forcat e RENEAS

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Ora 21:02

Hamza Uka u vetëdorëzua i plagosur, por RENEA s'ka shtënë drejt banesës në Fushë Arrëz ku 'u ngujua' me Julian Cumrakun (FOTO)



Hamza Uka

Hamza Uka, njëri prej të armatosurve që iu dorëzuan policisë mbrëmjen e sotme, pas dhjetëra orëve negociata dhe thirrje nga RENEA, rezulton të jetë i plagosur.

Ende nuk është e qartë se si është plagosur pasi policia dhe RENEA nuk kanë shtënë drejt banesës ku po fshiheshin prej muajsh Hamaza Uka dhe Julian Cumraku.

Report Tv mëson se Hamza Uka ka qenë edhe komando në Irak.

K.M/Shqiptarja.com

Share

Ora 20:32

Vijon operacioni i RENEA-s në Fushë Arrëz, 34- vjecari: Nuk dorëzohem, kërkojnë të më vrasin

Vijon që prej mëngjesit të sotëm aksioni i forcave RENEA-s në Fushë-Arrëz për neutralizimin e 2 personave të armatosur

Burime për Report Tv bëjnë me dije se në banesë ku qëndrojë dy personat ka shkuar vëllai i njërit nga personat dhe motra e personit tjetër, por asnjëri prej tyre s'ka pranuar që t'i përgjigjet thirrjeve të policisë për tu dorëzuar.

Forcat e policisë kanë përdoru megafon për t'i bërë thirrje që të dorëzohen, ndërsa Julian Çumraku u ka thënë policisë se unë nuk dorëzohet pasi duan që ta vrasin.

Personi tjetër i armatosur dyshohet Hamza Uka, ish punonjës ushtarak, prej kohësh në vëzhgim nga Antiterrori.

S.B/Shqiptarja.com

Share

Ora 19:56

Foto EKSKLUZIVE nga aksioni i RENEA-s në Fushë-Arrëz për neutralizimin e 2 personave të armatosur

Report Tv ka siguruar foto ekskluzive nga aksioni i RENEA-s në fshatin Orosh të Fushë-Arrëzit, ku prej mëngjesit të ditës së sotme po punohet për kapjen ose neutralizimin e 2 personave të armatosur që fshihen brenda një objekti të pabanuar.

Shtëpia është në pronësi të Mehill Cumraku (Jaku), ndërsa njëri prej tyre është identifikuar si Julian Cumraku 34 vjeç, ndërsa tjetri dyshohet me mbiemrin Uka. Njëri prej personave raportohet të jetë edhe nipi i Mehill Jakut.

K.M/Shqiptarja.com

Share

Ora 18:46

Fushë Arrëz/ Dy të armatosur të ngujuar, policia shoqëron drejt banesës vëllain e njërit prej tyre për negocimin

Policia ka shoqëruar drejt banesës ku janë të ngujuar dy personat vëllain e Julian Çumrakut, njërin prej të ngujuarve me qëllim negocimin.

Burime për Report Tv bëjnë me dije se në fshatin Orosh ka mbërritur edhe një tjetër skuadër e specializuar e Reneas.

Personi tjetër dyshohet se është një person me mbiemrin Uka dhe ky i fundit i dyshuar për terrorizëm.

S.B/Shqiptarja.com

Share

Ora 17:03

Fshati Orosh i rrethuar nga policia, Report Tv sjell pamjet ekskluzive të banesës ku fshihen 2 personat e armatosur

Gazetari i Report Tv Armir Mehaj ka siguruar pamjet nga banesa e pabanuar e cila është 'blinduar' nga forca të shumta policie. Brenda banesës ndodhen dy persona të armatosur, njëri i identifikuar si Julian Cumraku 34 vjeç. Të dy këta persona raportohet se qëndrojnë në këtë banesë që prej muaji. Godina është në pronësi të Mehill Jakut ndërsa njëri prej personave në fjalë, është nipi i tij.

Shtëpia është rrethuar që prej mëngjesit nga policia e Pukës, ndëras pas dështimit të negociatave për tu vetëdorëzuar, në zonë kanë mbërritur dhe forcat RENEA. Nga pamjet shihet prezenca e lartë e policisë.

K.B/Shqiptarja.com

Share

K.B/K.M/Shqiptarja.com

TAG: julian cumraku | mehill jaku | puke | Shkoder | orosh | Renea

Komento

Komente

Turi: 24/11/2025 17:16

Mos harxhoni kohen kot nese jane vrases po mbaroni pune shpejt me ta i digjni si miu

Përgjigju

Ta Rras Bulba: 24/11/2025 17:03

Sa me shpejt afer Allahut!

Përgjigju

Çami: 24/11/2025 16:47

Është Doqja.

Përgjigju

Kim: 24/11/2025 18:21

Po nuk jan tu dhan info media shum pak dicka po mbulojn

Shkodra: 24/11/2025 14:56

Ishalla esht ndonje peshk i madh , nuk ju shkon mundi dem

Përgjigju

Lezhjani: 24/11/2025 15:56

Vështire se del kot Renea, o ndonjë peshk i madh o ndonjë psikopat i rrezikshem

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Kë ka luftuar më shumë SPAK deri sot?

20 Nëntor, 13:08

Korrupsionin | Krimin e organizuar | Asnjërën

Lajme të tjera

Lëvizte me armë me vete në makinë, pranga 23-vjeçarit nga Shkodra! I sekuestrohet edhe kanabis (EMRI+VIDEO)

23 Nëntor, 12:29

Reshjet e dëborës në Qafë Thore-Theth, vijon puna për pastrimin e segmentit rrugor (VIDEO)

23 Nëntor, 12:24

Moti i keq/ Lëpusha dhe mali i Krrabit nën petkun e dëborës, pamjet mahnitëse (VIDEO)

23 Nëntor, 11:30



Reshjet e dëborës në Bogë-Theth, trashësia arrin deri në 40 cm (VIDEO)

23 Nëntor, 09:48

Vendi i përfshirë nga shi i dendur, në Shkodër nis dhe dëbora (VIDEO)

22 Nëntor, 17:09



Dita e Alfabetit, Begaj në Universitetin e Shkodrës: Mbroni gjuhën nga teknologjia dhe globalizmi

22 Nëntor, 15:11



Zbulohet 'foleja' e prostitucionit në Shkodër, arrestohet 23-vjeçarja braziliane dhe një tjetër

21 Nëntor, 11:00

Kanosën efektivin e 'Shqiponjave' për një gjobë, përfundojnë në gjyq dy vëllezërit në Shkodër! Njëri punonjës i FNSH

18 Nëntor, 15:50

Malësi e Madhe/ Rrufeja shkakton zjarr në një banesë dykatëshe, shtëpia shkrumbohet tërësisht nga flakët

18 Nëntor, 09:47

Moti i keq/ Ministrat takim me 12 prefektët e kryebashakiakët: Të koordinohemi për menaxhimin e situatës! Mbetën të bllokuar në një aks të Shkodrës, evakuohen 9 persona

17 Nëntor, 16:42

Shqipëria i vendos 'traun' në doganë misrit serb, bllokohen në Hanin e Hotit 21 kamionë me 520 tonë! Kreu i AKU: Rezultuan me aflatoksinë

Ergys Kavaja

17 Nëntor, 13:27

Parakalime të gabuara dhe në timon nën efektin e alkoolit, Rrugorja e Shkodrës: 15 shoferë në pranga, 15 në hetim! Mbi një mijë gjoba të vendosura

17 Nëntor, 11:16

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje